



REPUBLIKA E SHQIPËRISË




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË  
GJIROKASTËR

**ANALIZA VJETORE E PROKURORISË SË RRETHIT GJYQËSOR GJIROKASTËR PËR VITIN  
2017**

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, duke zbatuar kërkesat e legjislacionit penal dhe procedural penal, urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që normojnë punën, si organ i procedimit penal ka përmbushur për periudhën 01 Janar-31 Dhjetor 2017, detyrat në fazat e hetimeve paraprake, të gjykimit, të ekzekutimit të vendimeve penale.

Zyra e Rregjistrimit të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës Gjirokastrë për periudhën 01.01.2017-31.12.2017, ka evidentuar të rregjistruara **844** procedime penale me **184** persona nën hetim, **230** të pandehur, me **68** persona të hetuar me mase sigurimi "*arrest ne burg*".

**Tabela e regjistrimeve të reja për vitin 2016 dhe 2017**



	Gjithesëj Regjistruar	Persona nen hetim	Pandehur	Mase sigurimi arest ne burg	Mbartut nga viti paraardhes
■ 2016	898	161	284	99	274
■ 2017	844	184	230	68	454


Jane mbartuar nga viti 2016 per vitin 2017, gjithesëj **454** procedime penale me gjithesëj **76** persona nen hetim, **88** te pandehur nga te cilet **21** prej tyre me mase sigurimi “arrest ne burg”.

Eshte marre vendim per mosfillimin e procedimit penal per vitin 2017 per 349 materiale kallzuese .

Nuk eshte rregjistruar asnje veper penale e parashikuar nga K.P.Ushtarak.

***Ne total per vitin 2017 nga ana Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare Gjirokaster jane hetuar 1298 procedime penale, me 260 persona nen hetim, 318 te pandehur, nga te cilet 89 hetuar me mase sigurimi “arrest ne burg”***


## Tabela procedimeve gjithsej gjatë 2016 dhe 2017



	Gjithesej gjate vitit	Persona nen hetim	Pandehur	Mase sigurimi arest ne burg
2016	1172	205	360	132
2017	1298	260	318	89

Nga tërësia e procedimeve penale për të cilat është ushtruar ndjekja penale për vitin 2017, kanë përfunduar hetimet paraprake dhe u është dhënë zgjidhje ligjore, brenda vitit 2017 (*bashke me ceshtjet e mbartura*) një totali prej **710** procedime penale, me 84 persona nen hetim, 314 te pandehur nga te cilet 63 me mase sigurimi "Arrest ne burg".

## Tabela procedimeve të përfunduara gjatë 2016 dhe 2017



	Gjithesej gjate vitit	Persona nen hetim	Pandehur	Mase sigurimi arest ne burg
2016	668	59	360	109
2017	710	84	314	63

Jane mbartur ne hetim, per vitin 2018 nje total prej 588 procedime penale, me 176 persona nen hetim, nga te cilet 26 prej tyre hetohen me mase sigurimi personal "Arrest ne burg".


Është vendosur dërgimi në gjyq për 267 procedime penale, me totalin prej 317 te pandehur, nga te cilet 60 kane qene me mase sigurimi "Arrest ne burg".

Me ndryshimet e miratuara ne K.Pr.Penale, i jane derguar Gjykates Shkalles se Pare 07 kerkesa per miratimin e urdherit penal, me 07 te pandehur, kryesisht per vepren penale: "Kalim i paligjshem i kufirit", veper penale e parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal, nga te cilat jane miratuar 05 kerkesa dhe jane refuzuar 02 kerkesa per shkak te mosnjoftimit te te pandehurit me kerkesen per miratimin e urdherit penal.

Nga totali prej 267 procedime penale te derguara per gjykim, 49 procedime penale i jane derguar gjykates ne séance paraprake, referuar ndryshimeve ne K.Pr.Penale, me kerkese per dergimin e ceshtjes ne gjyq, me 51 te pandehur, asnje me mase sigurimi "arrest ne burg".Pra behet fjale per ceshtje te derguara ne gjykim pas muajit gusht 2017.


Nga ana e Gjykates jane miratuar 46 kerkesa te prokurorise me objekt dergimin e ceshtjes ne gjyq, kurse tre kerkesa jane ende ne shqyrtim gjyqesor.

Jane gjykuar 127 procedime penale me gjithesej 147 te pandehur nga te cilet 42 jane me mase sigurimi personal "arrest ne burg". Duke perfshire edhe 07 ceshtje penale per te cilat eshte miratuar nga gjykata urdher penal, ne total jane gjykuar 134 procedime penale me 154 te pandehur, me 42 te pandehur me mase sigurimi arrest ne burg.




Mbeten ne gjykim 133 procedime penale, me 163 te pandehur, nga te cilet 18 te pandehur jane me mase sigurimi "arrest ne burg".

Nga procedimet e mesiperme 99 prej tyre jane gjykuar me procedure te gjykimit te shkurtuar, me 119 te pandehur , 21 procedime penale me 21 te pandehur jane proceduar me gjykim te zakonshem, dhe kemi 07 raste te gjykimit te drejtperdrejte me 07 te pandehur.



Nga ana e prokurorit per 21 te pandehur eshte kerkuar denimi me gjobe, per 37 te pandehur eshte kerkuar denimi me burgim( *mesatar*) ,per 87 te pandehur nga ana e prokurorit eshte kerkuar pezullimi i ekzekutimit te vendimit te gjykates, kurse per 01 procedim me 01 te pandehur eshte kerkuar terheqja e akteve, kerkese e cila eshte pranuar nga gjykata dhe ceshtja vazhdon te jete ne hetim paraprak

## Kërkimet nga prokuroria në gjykatë viti 2017



Ne diskutim perfundimtar nga ana e perfaqesuesit te prokurorise eshte kerkuar kryesisht denimi me gjobe per vepren penale:-“ *Kalim i paligjshem i kufirit*”, ose per kundervatje penale me rrezikshmeri te ulet.

Nga ana e gjykates per 21 te pandehur eshte vendosur denimi me gjobe sipas kerkeses se prokurorit,denim mesatar me burgim ka vendosur per 36 te pandehur, per nje te pandehur ka vendosur pushimin e ceshtjes , pafajesi nuk ka, nenin 59 e ka aplikuar per 88 te pandehur, nga 87 te pandehur qe kane qene kerkesa te prokurorit, pra nje rast kur prokurori ka kerkuar burgim gjykata ka aplikuar nenin 59, rast ky i ankimuar ne gjykatën e Apelit Gjirokaster .

Eshte vendosur pushimi i hetimit per 140 ceshtje penale, me 60 persona nen hetim, asnje prej nuk ka patur cilesine e te pandehurit, dy prej tyre hetuar me mase sigurimi personal “*arrest ne burg*”.Behet fjale per procedimin penal nr 273-2017, procedim i rregjistruar per vepren penale :-“*Plagosje e rende me dashje*”, parashikuar nga neni 88/1 K.Penal, ndjekur nga prokuror Z.Emror Kasaj. Nga akti ekspertimit mjeko-ligjor ka rezultuar se demtimet jane kategorizuar “*Plagosje e lehte*”, parashikuar nga neni 89 dhe i demtuari ka hequr dore nga ndjekja penale.Behet fjale nderkohe per procedimin penal nr 302-2017, rregjistruar per vepren penale “*Plagosje e lehte*”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, ceshtje e ndjekur nga Z.Arjan Muca. I demtuari ka hequr nga ndjekja penale dhe ne keto rrethana eshte pushuar hetimi.

Nga totali prej 140 ceshtje te pushuara, 93 jane pushuar per shkaqe te tjera, ku perfshihen ceshtje te cilat ndiqen mbi ankimin e te demtuarve, te cilet kane hequr dore nga ankimi, si edhe ceshtje te cilat jane amnistuar nga Ligji:-“*Per dhenie amnistine*” Nr 141/2016, miratuar ne dt 22.12.2016.

Jane pushuar 14 ceshtje per mungese fakti, ku kryesisht perfshihen raste te humbjes dhe rigjetjes se aparateve celulare, si edhe 33 ceshtje per mungese provash dhe shkaqe te tjera, ku sikurse u theksua me larte jane dy persona me mase sigurimi “*arrest ne burg*”

Pas ndryshimeve te miratuara ne K.Pr.Penale, jane derguar prane gjykates 14 kerkesa per pushimin e ceshtjes, me 12 persona nen hetim, asnje me mase sigurimi “*arrest ne burg*”. Nga ana e gjykates jane miratuar dy kerkesa per pushimin e ceshtjes, kurse ceshtjet e tjera jane ende ne shqyrtim gjyqesor.


Gjate vitit 2017 jane pezulluar 260 ceshtje penale, me 08 persona nen hetim, asnje prej tyre me mase sigurimi “*Arrest ne burg*”.

Jane transferuar ne prokurori te tjerat, duke u shpallur moskompetenca 29 ceshtje penale me 14 person nen hetim, nga te cilet nje me mase sigurimi personal “*arrest ne burg*”

Kryesisht eshte shpallur moskompetenca per procedime penale te cilat jane rregjistruar per vepren penale:-“*Kalim i paligjshem i kufirit*”.


Sikurse u theksua gjate vitit 2017, kane qene nen hetim 260 persona + 318 te pandehur:- **totali prej 578 personash**, me 89 person te hetuar me mase sigurimi “*Arrest ne burg*”.

Me arsim deri ne 09 klase jane 230 persona, te mesem 328 dhe me arsim te larte 20. Nga keta 12 jane shtetas te huaj dhe nga totali i personave nen hetim 12 jane te seksit femer, nga te cilat 01 e mitur dhe 11-te madhore.



Te punesuar ne sektorin privat jane 32 persona, nenpunes te thjeshte jane 2 persona, niveli ulet 06, niveli i mesem 12 persona, niveli i larte 02 persona, 05 pandehur jane te rolit baze( *punonjes policie*) dhe 524 persona jane te papune. Nga personat e mesiperme 282 persona rezultojne me banim ne qytet dhe 296 rezultojne me banim ne komuna.

## Të pandehur sipas Punesimit viti 2016 dhe viti 2017




	Sekori privat	Nenpunes I thjesht	Pa pune
■ 2016	43	13	507
■ 2017	32	2	524

Nga totali i pergjithshem rezultojne te denuar recidiviste 44 te pandehur, kryesisht per vepren penale te vjedhjes se pasurise nga te cilet 25 per te njejten veper penale, kurse perserites per vepra te ndryshme penale jane 19 autore te veprave penale, pjesa tjeter prej 534 personash te proceduar penalisht rezultojne te padenuar me pare.

Nga numri i personave te hetuar nga totali prej 578 personash te proceduar, 39 persona jane te mitur, madhore mbi 18 vjec jane 539 persona.

***Per te patur nje ide me te qarte mbi sa u pershkrua me siper, si edhe mbi raportin e ceshtjeve te derguara ne gjykim, pezulluara dhe pushuara, po ricitojme se ne total jane hetuar gjate vitit 2017, 1298 procedime penale (bashke me procedimet e mbartura te vitit 2016 dhe te ardhura me transferim) dhe nga keto procedime 267 jane derguar ne gjykim, 260 jane pezulluar, 140 jane pushuar, 29 jane transferuar dhe 588 procedime penale jane mbartuar ne hetim per vitin 2018.***





Rezulton se numri i ceshtjeve te derguara per gjykim eshte i perafert me numrin ceshtjeve te pezulluara dhe eshte tentuar te ulet numri i ceshtjeve te pushuara.

Nga ceshtjet e shqyrtuara ne Gjykatën e Shkalles se Pare Gjirokaster per vendimet e themelit te marra nga kjo gjykate, jane apeluar nga perfaqesuesi i prokurorise dhe te pandehurit ne total 80 vendime themeli.

Nga perfaqesuesi i prokurorise jane paraqitur 28 apelime, nga te cilet 14 apelime per pafajesi, 03 per pushim ceshtje, 03 per ndryshim kualifikimi, 08 per denim te bute .

Nga 14 apelime per pafajesi ,nga ana e Gjykates se Apelit per 05 raste eshte lene ne fuqi vendimi i shkalles se pare per pafajesi, kurse per 04 ceshtje eshte pranuar apeli i prokurorit duke u dhene fajesi. Per 05 ceshtje eshte hequr dore nga ankimi ne apel.

Nga 08 apelime te Prokurorise qe kane te bejne me masen e denimit te dhene nga gjykata, Gjykata e Apelit ne 04 raste ka pranuar apelimin duke pranuar kerkesen e prokurorit, per 04 raste ka lene ne fuqi vendimin e gjykates se shkalles se pare .

Per 03 ankime qe kane te bejne me ndryshimin e kualifikimit, nje ankim i prokurorit eshte pranuar dhe 02 vendime te Gjykates se Shkalles se Pare jane lene ne fuqi.


Ne lidhje me masat e sigurimit te dhena nga Gjykata e Shkalles se Pare Gjirokaster, nga ana e perfaqesuesit te Prokurorise dhe te personave nen hetim jane ushtruar 60 apelime.

Nga sa me siper nga ana e perfaqesuesit te prokurorise jane ushtruar 11 apelime. Gjykata e Apelit ka pranuar per 04 persona apelin duke ndryshuar masen e sigurimit ne "arrest ne burg" sipas kerkeses se prokurorit, kurse per 07 raste ka lene fuqi vendimin e gjykates se shkalles se pare.

Në një referencë të tillë ndarja e veprave penale, të pandehurëve dhe mënyrës të zgjidhjes përfundimtare të procedimeve të rregjistruara dhe atyre të mbartura për vitin 2018, rezulton si më poshtë:-

### **KRIMET KUNDËR PERSONIT**

Nga tërësia e procedimeve penale, të rregjistruara gjatë vitit 2017, evidentohen **60** procedime penale të regjistruara për vepra penale kundër personit, **kreu II** Seksionet I; III;VI;VII;VIII;IX :X të K.Penal, me 12 persona nën hetim, 12 të pandehur, nga të cilët 05 me masë sigurimi “*arrest ne burg*”. Të mbartura nga viti 2016 janë 27 procedime penale me 05 nën hetim dhe 13 të pandehur nga të cilët 06 me masë sigurimi “*arrest ne burg*”.



Ne total janë pushuar 19 procedime penale, nga të cilat është pushuar 01 procedim penal për mungesë fakti, 13 për shkaqe të tjera dhe 05 procedime për mungesë provash me të tjerë nën hetim nga të cilët dy me masë sigurimi arrest ne burg, të caktuara edhe më lartë. Janë pezulluar 06 çështje pa autor, transferuar 01 çështje dhe janë dërguar për gjykim 21 procedime penale me 24 të pandehur nga të cilët 08 me masë sigurimi “*arrest ne burg*”. Janë gjykuar 12 procedime penale me gjykim të shkurtuar me total 12 të pandehur. Është proceduar në gjykate me gjykim të zakonshëm për një çështje me 01 të pandehur. Nuk ka pafajesi për këto figura veprash penale.

Theksohet se është vlerësuar maksimalisht kundërvajtje penale:- “*Plagosje e lehte*”, parashikuar nga neni 89 i K.Penal, për të cilën gjatë vitit 2017 janë hetuar 14 raste+ 01 çështje e mbartur nga viti 2016, duke shkuar në total 15 çështje të hetuara gjatë vitit 2017. Me 05 persona nën hetim, 05 të pandehur nga të cilët 02 me masë sigurimi “*arrest ne burg*”. Çështjet janë ende në gjykim.

Në hetimin e kësaj figure të veprës penale është cmuar se këto ngjarje pra plagosje e lehte dhe rrahja gjenerojnë ngjarje të rënda shpesh me pasoja për jetën, dhe në këto rrethana i kushtohet rëndësi e madhe jo vetëm hetimit, por edhe caktimit të masave të sigurimit si edhe denimit të autoreve.

Po keshtu i eshte kushtuar vemendje e vecante vepres penale :-*“Dhune ne familje”*, parashikuar nga neni 130/a e Kodit Penal. Gjate vitit 2017 jane rregjistruar 10 procedime, me 07 persona nen hetim, 03 te pandehur, nga te cilet asnje me mase sigurimi *“arrest ne burg”*. Jane mbartur nga viti 2016, 10 procedime penale me 05 persona nen hetim, 05 te pandehur nga te cilet 02 me mase sigurimi personal *“arrest ne burg”*.Pra ne total jane hetuar 20 procedime penale me 12 persona nen hetim, 08 te pandehur nga te cilet 02 me mase sigurimi *“arrest ne burg”*

Jane derguar per gjykim 09 ceshtje per kete figure vepre penale, nga te cilat nje ceshtje eshte derguar pas muajit gusht 2017( *pas ndryshimeve ne K.Pr.Penale*) me kerkese per dergimin e ceshtjes ne gjyq, kerkese e cila eshte pranuar nga gjykata.

Ka perfunduar gjykimi per 06 ceshtje nga te cilat 04 ceshtje me 04 te pandehur jane gjykuar me proceduren e gjykimit te shkurtuar, kurse 01 ceshtje me 01 te pandehur eshte proceduar me gjykim te zakonshem.Per nje ceshtje me 01 te pandehur eshte paraqitur kerkese per marrjen e mjeksore, kerkese e cila eshte pranuar nga gjykata.Nuk ka patur raste te dhenies se pafajesise apo pushim te gjykimit.


Gjithashtu rendesi e vecante, i eshte kushtuar vepres penale *“Perndjekje”*, veper penale e parashikuar nga neni 121/a e Kodit Penal. Gjate vitit 2017 jane evidentuar 05 raste te kesaj figure te vepres penale, me 04 persona nen hetim, 01 i pandehur me mase sigurimi *“arrest ne burg”*. Jane mbartur nga viti 2016, 03 ceshtje penale me 01 person nen hetim dhe 02 te pandehur, pa te arrestuar.Pra ne total per kete figure te vepres penale jane hetuar 08 ceshtje penale, me 05 persona nen hetim, 03 te pandehur, nga te cilet 01 me mase sigurimi *“arrest ne burg”*.

Jane derguar per gjykim 03 procedime me 03 te pandehur, me 01 mase sigurimi *“arrest ne burg”* , nga te cilat jane gjykuar 03 ceshtje me 03 te pandehur me gjykim te shkurtuar .Per dy te pandehur eshte kerkuar denim me burgim( *mesatar*) dhe nga ana e gjykates eshte pranuar kerkesa e perfaqesuesit te prokurorise.Per nje te pandehur eshte kerkuar aplikimi i nenit 59 te Kodit Penal , kerkese e cila eshte pranuar nga ana e gjykates.

### **VEPRA PENALE TE KRYERA KUNDER PASURISE DHE NE SFEREN EKONOMIKE**

Jane rregjistruar **328** procedime për vepra penale të kryera kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, **Kreu III** seksionet I; II; III; V; VI; VII ;VIII ; X; XI; të K.Penal; me 30 persona nen hetim , 76 te pandehur, nga te cilet 32 me mase sigurimi *“arrest ne burg”*.

Jane mbartur nga viti 2016 gjithesej 104 procedime penale me 07 persona nen hetim 24 te pandehur, nga te cilet 02 me pase sigurimi *“arrest ne burg”*.



*Konstatohet se krahasuar me vitin 2016 ka rritje te krimet kunder pasurise, afersit ne masen \_\_\_\_\_*

Ne total gjate vitit 2017 jane hetuar 432 procedime penale, me 37 persona nen hetim, 100 te pandehur, nga te cilet 34 me mase sigurimi "arrest ne burg"

Konkretisht ne lidhje me vepren penale te "Vjedhjes pasurise", parashikuar nga neni 134/1 K.Penal, jane rregjistruar 143 procedime penale, me 2 persona nen hetim, 10 te pandehur, nga te cilet 04 me mase sigurimi "arrest ne burg".

Jane mbartur nga viti 2016, 49 procedime penale me 02 persona nen hetim, 05 te pandehur nga te cilet 02 me mase sigurimi "arrest ne burg". ***Pra ne total per vepren penale "Vjedhje e pasurise", veper penale e parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal jane hetuar gjate vitit 2017, 192 procedime penale me 04 persona nen hetim, 15 te pandehur nga te cilet 06 me mase sigurimi "arrest ne burg".***

Duke marre ne raport numrin e ceshtjeve me ate te personave te evidentuar si autore te kesaj vepre penale, konstatohet se ka zbulueshmeri te ulet, cka tregon se duhet ti kushtohet vemendje hetimit te kesaj figure te vepres penale si nga policia ashtu edhe nga prokuroria.

Njekohesisht konstatohet se autore te vepres penale te vjedhjes jane 02 te mitur.

Kryesisht numri i personave te evidentuar si autore te kesaj figure krimi jane te papune dhe me arsim deri ne 09 klase jane 14 persona dhe krejtesisht pa te ardhura. Jane pese persona perserites per te njejten figure krimi.

Per kete figure krimi jane pushuar 05 ceshtje penale per mungese fakti (kryesisht kallzime per vjedhje aparati celular), jane pezulluar 99 ceshtje me nje person nen hetim dhe jane derguar gjyqit 15 procedime me 15 te pandehur nga te cilet 04 me mase sigurimi "arrest ne burg".

Nga 15 procedime te derguara ne gjykate, jane gjykuar 06 procedime penale me 06 te pandehur, me gjykim te shkurtuar. Nuk ka pafajesi. Vendimet e gjykates ne pergjithesi kane qene ne perputhje me kerkesen e prokurorit te seances. Eshte kerkuar denimi me burgim (*mesatar*), kerkesa te cilat jane pranuar nga ana e gjykates.

Ne lidhje me vepren penale "*Vjedhje e pasurise*" (e cilesuar), parashikuar nga nenet 134/2 dhe 134/3 te Kodit Penal, jane rregjistruar 12 procedime penale me dy (02) persona nen hetim, 32 te pandehur, nga te cilet 19 me mase sigurimi "*arrest ne burg*"

Jane mbartur nga vitit 2016, 02 procedime penale me 02 persona nen hetim, 02 te pandehur pa mase sigurimi .

Ne total jane hetuar 14 ceshtje penale me 04 persona nen hetim, 34 te pandehur, nga te cilet 19 me mase sigurimi "*arrest ne burg*".

Nuk ka ceshtje te pushuara, por per dy persona nen hetim eshte vendosur pushimi i hetimit per mungese provash, pa mase sigurimi, kurse procedimi ne kete rast ka shkuar per gjykim me 04 te pandehur me mase sigurimi "*arrest ne burg*".

Eshte pezulluar nje ceshtje me dy persona nen hetim, pa mase sigurimi dhe jane derguar per gjykim 12 procedime me 34 te pandehur nga te cilet 19 me mase sigurimi "*arrest ne burg*".

Jane gjykuar me procedure te shkurtuar 09 ceshtje me 23 te pandehur. Jane denuar me burgim 11 te pandehur me denim mesatar dhe per 12 te pandehur eshte aplikuar neni 59 i Kodit Penal.

Qendrimi i gjykates ka qene i njejte me kerkesen e perfaqesuesit te akuzes. Sikurse konstatohet ne kete figure te vepres penale ka numer te larte te autoreve te mitur, 21 te pandehur te mitur, te papune dhe te paarsimuar.

Ne lidhje me vepren penale: "*Vjedhje duke shperdoruar detyren*" , veper penale e parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal, gjate vitit 2017 jane rregjistruar 03 ceshtje penale si edhe jane mbartur nga viti 2016 03 ceshtje, te cilat jane ende ne hetim paraprak.

Ne lidhje me vepren penale: "*Vjedhje me dhune*", veper penale e parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal, jane rregjistruar 07 procedime penale, me nje person nen hetim dhe me 02 te pandehur nga te cilet 02 me mase sigurimi "*arrest ne burg*".

Jane mbartur nga viti 2016 , 02 procedime penale pa autor. Pra ne total jane hetuar 10 procedime penale me 01 nen hetim, 02 te pandehur me 01 "*arrest ne burg*"

Jane derguar per gjykim 02 procedime penale me 02 te pandehur nga te cilet 02 me mase sigurimi "*arrest ne burg*". Jane gjykuar dy procedime me dy te pandehur me gjykim te shkurtuar, por per nje te pandehur (*Ferdinant Arapi me prokuror J.Cafka*) eshte ndryshuar kualifikimi ne gjykim ne vjedhje te thjeshte, parashikuar nga neni 134 i K.Penal.

Jane deklaruar fajtor , denuar me burgim (*mesatar*). Gjykata ka pranuar kerkesen e perfaqesuesit te organit te akuzes ne lidhje me ndryshimin e kualifikimit dhe me masat e denimit.

Ne lidhje me vepren penale :- "*Vjedhje energjise elektrike*", parashikuar nga neni 137/1 dhe 2 te K.Penal, jane rregjistruar 05 procedime penale, me 02 nen hetim, 03 te pandehur, pa mase sigurimi . Jane mbartur 03 procedime penale me 03 te pandehur, 02 me mase sigurimi "*detyrim per paraqitje*"

Jane derguar per gjykim 05 ceshtje, me 06 te pandehur, nga te cilet 02 me mase "*detyrim per paraqitje*". Jane gjykuar me gjykim te shkurtuar 05 ceshtje me 06 te pandehur,

per te 06 eshte deklaruar fajesi. Per 06 te pandehur eshte aplikuar pezullimi i denimit me burgim.Kjo veper penale nuk ka patur shkalle te madhe perhapje ne njesine tone administrative dhe eshte ulur me shume numri i rasteve te referuara gjate vitit 2017.

Ne lidhje me vepren penale:-“*Mashtrim*”, veper e parashikuar nga neni 143/1 dhe 143/2 i K.Penal gjate vitit 2017, jane rregjistruar 22 procedime penale me 05 te pandehur nga te cilet 04 me mase sigurimi “*arrest ne burg*”.Jane mbartur nga viti 2016 08 procedime penale me 06 te pandehur( *pa masa sigurimi*).

Pra, ne total jane hetuar 30 procedime penale me 11 te pandehur, nga te cilet 04 me mase “*arrest ne burg*”. Jane derguar per gjykim 02 procedime penale me 05 te pandehur nga te cilet 02 me mase sigurimi “*arrest ne burg*”.Eshte derguar kerkese per dergimin e ceshtjes ne gjyq per 01 te pandehur me mase sigurimi “*arrest ne burg*”.Eshte gjykuar 01 procedim penal me gjykim te shkurtuar, eshte kerkuar fajesi dhe denim me burgim( *mesatar*), kerkese e cila eshte pranuar nga gjykata.

Ne lidhje me vepren penale:-“*Kontrabandes ...*” nga neni 172-174 ne disa forma, jane rregjistruar 23 procedime penale, me 06 persona nen hetim, 06 te pandehur, nga te cilet 03 me mase sigurimi “*arrest ne burg*”.Mbartur nga viti 2016 01 procedim pa autor

Jane derguar per gjykim 04 procedime me 04 te pandehur nga te cilet 03 me mase sigurimi “*arrest ne burg*”.Eshte proceduar me gjykim te shkurtuar per 03 raste me 03 te pandehur, nje 01 mase sigurimi “*arrest ne burg*” nga te cilet eshte kerkuar 02 te pandehur gjobe dhe per 01 te pandehur eshte kerkuar aplikimi i nenit 59.Nga ana e gjykates jane pranuar kerkesat e prokurorit. Jane pushuar hetimet per dy procedime pa te pandehur per mungese fakti.Eshte shpallur moskompetenca lendore per 12 procedime penale.

Ne lidhje me vepren penale :-“*Kontrabande nga punonjes doganore*”, parashikuar nga neni 175 i K.P, eshte rregjistruar nje ceshtje me 02 te pandehur,me mase sigurimi “*detyrim paraqitje*”.Ceshtja eshte derguar ne gjykim, gjykuar me procedure te gjykimit te shkurtuar, deklaruar fajtor, per nje te pandehur eshte aplikuar neni 63, pune ne interes publik, kurse tjetri denuar me kusht.

Ne lidhje me vepren penale te “ *Organizmit te llotarive*”, parashikuar nga neni 197 i K.Penal eshte rregjistruar 01 procedim penal me 01 person nen hetim pa mase sigurimi personal.Eshte mbartur 01 ceshtje me 01 te pandehur, pra ne total jane hetuar 02 procedime me 02 persona nen hetim.Ceshtjet jane ende ne hetim.

Ne lidhje me vepren penale:-“*Ndertim i paligjshem*”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal jane rregjistruar 06 procedime penale me 02 te pandehur, ceshtje te cilat jane derguar per gjykim.Eshte gjykuar nje ceshtje me 01 te pandehur, deklaruar fajtor dhe denuar me kusht.


#### **VEPRA PENALE KUNDER MJEDISIT**

Kreu **IV**:- Jane rregjistruar ne vitin 2017 **17** procedime penale për vepra penale kundër mjedisit me 01 person nen hetim si edhe jane mbartur nga viti 2016 05 procedime pa autor Kreu **IV**;

Numri i veprave penale te ketij kreu, konkretisht “Prerjes se paligjshme te pyjeve” parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal, rezulton te jete me i larte, por per shkak te ekzistences se VKM mbi trajtimin e prerjes se paligjeshme te pyjeve si kundervajtje administrative, prokuroria ka hasur pengese ne hetimin dhe dergimin ne gjyq te ketyre rasteve.

### **VEPRA PENALE KUNDER AUTORITETIT TE SHTETIT**

Kreu VIII Seksionet I;II;III;IV :- Jane rregjistruar 404 ne vitin 2017 procedime penale për vepra penale kundër autoritetit të shtetit me 138 persona nen hetim, 140 te pandehur, nga te cilet 31 me mase sigurimi “arrest ne burg”. Mbartur nga viti 2016 ,313 procedime penale me 63 persona nen hetim, 50 te pandehur , nga te cilet 13 me mase sigurimi “arrest ne burg”.



Jane pushuar gjithesej 79 procedime penale, 04 per mungese fakti me 01 person nen hetim pa mase, 07 per mungese provash me 04 persona nen hetim, pa mase , dhe 68 per shkaqe te tjera me 40 persona nen hetim.

Ketu perfshihet vepra penale e “Perdorimi me keqdashje te thirrjeve telefonike”, parashikuar nga neni 275 K.Penal , per shkak te Ligjit:“Per dhenie Amnistie” si edhe 04 procedime per perdoruesit e lendeve narkotike. Jane filluar mbi bazen e ankimit 27 procedime penale nga te cilat per 19 eshte vendosur pushimi, pasi i demtuari akuzues e ka terhequr ankimin. Nisur nga praktika hetimore vlen te theksohet se ne lidhje me kete

dispozite duhet te kete nje interpretim te qarte se cfare duhet te konsiderohet “ perdorim me keqdashje” , pasi sikurse konstatohet rritet artificialisht numri i procedimeve te filluara dhe njekohesisht konstatohen raporte dhe meri personale midis ankuesve dhe te afermeve ose te njohurve te cilat nuk perbejne figure te vepres penale.Nese do te gjendej nje rregullim ligjor si psh abonenti te kerkonte tabulatet dhe kompania perkatese te kishte detyrimin ti vinte ne dispozicion, sigurisht keto akte do ti neneshtroheshin vleresimit paraprak te prokurorit dhe do bente te mundur vleresimin e faktit qysh ne fazen fillestare te paraqitjes se ankimit.Pra me qartesisht ankuesi duhet ta shoqeronte ankimin se bashku me tabulatet e thirjeve telefonike.

*Nga veprat penale te ketij kreu duhet te vecojme figurat e veprave penale:-*

*Neni 244 i Kodit Penal:-*

Jane rregjistruar 13 procedime penale, me 02 nen hetim dhe 10 te pandehur, te gjitha me mase sigurimi “detyrim per paraqitje”.Per 01 procedim eshte vendosur pushimi pasi nuk provohet kryerja e vepres penale, 10 procedime jane derguar per gjykim dhe dy jane ende ne hetim.Jane shqyrtuar 08 procedime penale me procedure te gjykimi te shkurtuar, me 08 te pandehur, te cilet jane deklaruar fajtores dhe eshte aplikuar neni 59 i K.P, per dy procedime me dy te pandehur eshte proceduar me gjykuar me gjykim te drejtperdrejte, jane deklaruar fajtor dhe denuar me burgim mesatar. Nga ana e gjykates jane pranuar kerkesat e prokurorit.

*Neni 248 i Kodit Penal:-*

Jane rregjistruar 24 procedime penale, me 02 te pandehur, 04 nen hetim, pa masa sigurimi.Jane mbartuar nga viti 2016 08 procedime penale me 01 te pandehur. Nga totali prej 32 procedime jane pushuar 03 ceshtje per mungese provash, jane derguar per gjykim dy ceshtje me 02 te pandehur, te cilat jane ende ne shqyrtim gjyqesor. Sipas ndryshimeve ne K.Pr.P i eshte kerkuar gjykates pushimi per nje ceshtje me 04 persona nen hetim, kerkese e cila eshte miratuar nga ana e gjykates.

*Neni 257/a i Kodit Penal;-*

